



Në bazë të nenit 7 alineja 9 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16, 164/18 dhe 190/19), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural njofton si në vijim:

THIRRJE PUBLIKE nr. 09 / 2022

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për mbështetjen financiare të zhvillimit rural për vitin 2022

I. LËNDË E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është dhënia e mbështetjes financiare për masën e radhës:

<i>Grupi i masave</i>	<i>Titulli i masës</i>	<i>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri)</i>
Masa 124	Investimet në infrastrukturë për zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore të destinuara për:	
124.3	Infrastruktura për qasje deri në tokën bujqësore	deri 1.000.000,00 denarë

II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

<i>Subjektet</i>	<i>Masa</i>
Njësitet e vetëqeverisjes lokale	124

III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Mbështetja financiare paguhet në parimin e financimit të investimeve të kryera nga përdoruesi në masën 100% të vlerës së kostove të pranueshme të miratuara për investimin. Mjetet nga mbështetja financiare me kërkesë të përdoruesit mund të ndahen në dy këste ose në përputhje me fazat e realizimit të investimit në bazë të situatave të përkohshme të mbikëqyrjes ose dokumentacionit për prokurimin e pajisjeve.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI PARASHTROHET

Kërkesa parashtrohet në origjinal.

Kushtet të cilat duhet t'i përmbushin kërkuessit e mjeteve janë përcaktuar me:

- Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2022 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/22, 81/22 dhe 88/22)
- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73 / 15, 88/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/18, 27/19, 152/19, 244/19, 275/ 19, 110/21 dhe 123/22)
- Rregulloren për kritere më të përafërta për përzgjedhjen e përfituesve sipas masave për zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17, 162/18, 100/19, 215/19, 24/20, 96/21, 276/21, 91/22 dhe 113/22) dhe
- Rregulloren për kushtet shtesë më të afërta për mbështetjen e masave të zhvillimit rural, kostot e pranueshme dhe shumën e mbështetjes për kostot e pranueshme për përdorues për një masë individuale. ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16, 59/16, 178/18, 77/19, 214/19, 276/21, 91/ 22 dhe 122/22)

Kërkuessit që i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzimin e mjeteve për masën 124, renditen me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kritere më të përafërta për përzgjedhjen e përfituesve nga masat e zhvillimit rural.

- Kërkesat që kanë të njëjtin numër pikësh do të renditen sipas datës dhe orës së dorëzimit të kërkesës
- Kërkuessit nuk duhet të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë.

V. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për mbështetje financiare" me listën e dokumenteve të kërkuara mund të merren në faqen e internetit të Agjencisë www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e mësipërm mund të merren edhe drejtpërdrejt në Agjenci çdo ditë pune nga ora 8:30 deri në 16:30 në adresën:

Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural,



Rr. Brigada 3 Maqedonase Nr. 20 (Ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup

VI. MËNYRA E PARASHTRIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e kompletuara për pagesën e mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2022 së bashku me gjithë dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënimin në këndin e sipërm majtas "MOS HAP", për Thirrje publike nr. 09/2022 dhe shënimi i shifrës së masës për të cilën është parashtruar kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet me postë ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk mban përgjegjësi për mbërritjen e vonuar dhe jo të plotë në sportel apo hapjen e hershme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 09.07.2022.

Kërkesat e paraqitura pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.

Kontakt:

Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Sektori për miratimin e projekteve

Telefoni 02 3097 - 460, çdo ditë pune prej ora 08.30 deri më 16.30

e-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk